VENDIM
Nr.128, datë 2.12.2011

MBI LIDHJEN E KONTRATËS, TË NEGOCIUAR NGA SHOQËRIA "CEZ SHPËRNDARJE" SHA PËR PROKURIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES PËR VITIN 2012

Në mbështetje të nenin 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar, pikës 2.10 të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.42, datë 25.5.2009 "Rregullat dhe procedurat standarde të prokurimit të energjisë elektrike" nga OSSH sh.a.", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e "CEZ shpërndarje" sh.a., si dhe relacionin e drejtorive teknike në ERE,

konstatoi se:

Pas shqyrtimit të procedurës së prokurimit të zhvilluar nga shoqëria "CEZ shpërndarje" sh.a., si dhe duke iu referuar rregullave dhe procedurave standarde të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a., në procesin e negocimit, realizohet kushti i parashikuar në "Rregulloren për procedurat standarde të prokurimit të energjisë elektrike: nga OSSH sh.a., në pikën 2.10, ku thuhet se ERE miraton lidhjen e kontratës me kusht që çmimi i pranuar në kontratë të jetë më i ulët se ai i ofertës së paraqitur në tenderin e anuluar përpara se të fillojë procedura me negocim.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të aprovojë lidhjen e kontratës së negociuar nga shoqëria "CEZ shpërndarje" sh.a. me shoqërinë EFT AG, sipas profilit:

EFT AG
Periudha 1.1.2012 – 31.12.2012
Fuqia: 150 MW CBC 100 % nga EFT
Sasia: 1,317,600 MWh
Çmimi /njësi: 62.40 euro/MWh

2. Ngarkohet "CEZ shpërndarje" sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani